



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**KESHILLI KOMBETAR I UJIT**  
**KESHILLI I BASENIT UJEMBLEDHES "VJOSA" VLORE**

---

**VENDIM**

Nr. 25, Dt. 06.08.2007

Per miratim ne parim te kerkeses, per dhenien me koncension, te burimit uJOR, Perroi i Gurres, (dege e lumit te Bences), per prodhim te energjise elektrike, subjektit "B.A.C" sh.p.k. Shijak - Durres.

Ne zbatim te Ligjit Nr.8093 Dt.21/03/1996 "Per Rezervat Ujore", te ligjit nr. 9663, dt.18.12.2006 "Per koncesionet", kreu IV, te Vendimit te K.M-ve nr. 27, dt. 19.01.2007, "Per miratimin e rregullave te vleresimit dhe dhenies te koncesioneve", kreu II, te vendimit te K.K.U-it, nr.3, dt. 19.07.2002 "Per miratimin e rregullores te Sekretariatit Teknik, te K.K.U-it, te K.B.U-es dhe A.U. -it", si dhe udhezimit te M.M.P.A.U dhe M.E.T.E, K.B.U "Vjose":

**VENDOSI:**

1. Miratimin ne parim te kerkeses, per dhenien me koncension, te burimit uJOR, Perroi i Gurres , (dege e lumit te Bences), per prodhim te energjise elektrike, subjektit "B.A.C" sh.p.k. Shijak - Durres.
2. Sasia e ujit qe jepet ne perdorim, per prodhim te energjise elektrike, do te jete 1 m<sup>3</sup>/sek.
3. Periudha e shfrytezimit te ujit, gjate gjithe vitit, perjashto, periudhen nga 01.06. deri me 30.09, ku sasise te mesiperme do ti zbritet 0.1 m<sup>3</sup>/sek, qe do te perdoret per ujitje.
4. Ngarkohet A.U.B "Vjose" Vlore, per zbatimin e ketij vendimi.
5. Ky vendim hyne ne fuqi menjehere.

**PERGJEGJESI I A.U.B "VJOSE"**

**VeZir METAJ**



**KRYETARE E K.B.U-se**

**Dorothe KONOMI**

